



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2480/ 5 prot

Datë 27.10.2025

V E N D I M
Nr. 1532/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 27.10.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h (degë e shoqërisë mëmë RSM COMPANY) SHPK, për procedurën e prokurimit “Proçedurë e hapur” me Nr. REF-53029-07-01-2025, me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës lidhëse të fshatit Dragu dhe fshati Koçaj, NjA Fushë Bulqizë” me fond limit: 20.500.000 (njëzet milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 17.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Bulqizë.
Adresë: Lagjia “Minatori” Bulqizë.

Ankimues:

Operatori ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h (degë e shoqërisë mëmë RSM COMPANY) SHPK me NIPT L04803001U, me adresë: Rruga “Xhorxhi Martini”, Nr. 20, Godinë 11-katëshe, Shk. 2, Kati. 7, Tiranë.

Subjekt i Interesuar:

Operatori ekonomik “K. Turja” SHPK me NIPT K81314014A, me adresë: Ura Gjoles, Budull, Bubq, Durrës.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:**I***Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 02.07.2025 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-53029-07-01-2025, me objekt “Sistemi asfaltim i rrugës lidhëse të fshatit Dragu dhe fshati Koçaj, NjA Fushë Bulqizë” me fond limit: 20.500.000 (njëzet milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 17.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë.

II.2. Në datën 17.07.2025 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 25.07.2025 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1- “R S M CONSTRUCTION” d.sh.h	15.019.904	lekë	skualifikuar
2- BOE “Gerti” SHPK & “Lis Konstruksion” SHPK	16.683.715.36	lekë	skualifikuar
3- “K. Turja” SHPK	17.076.518	lekë	kualifikuar
4- “Shehu” SHPK	17.224.300	lekë	skualifikuar
5- “Selami” SHPK	20.277.978	lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 25.07.2025 operatori ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit

- Nuk ploteson kriterin 2.3.1 në lidhje me punën e ngjashme.

II.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton së më datë 09.09.2025 është Publikuar Njoftim Fituesi Paraprak i procedurës së prokurimit objekt- ankimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga ana e autoritetit kontraktor.

II.6. Në datën 15.09.2025, nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. A/2025/5802 dhe me nr. 2480/2025 prot, datë 15.09.2025, e operatorit ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-53029-07-01-2025, me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës lidhëse të fshatit Dragu dhe fshati Koçaj, NjA Fushë Bulqizë” me fond limit: 20.500.000 (njëzet milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 17.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h me pretendimet si vijon:

E kundërshtojmë arsyen e skualifikimit, pasi autoriteti kontraktor është treguar i paqartë në lidhje me atë se çfarë konkretisht nuk plotësojmë në lidhje me punën e ngjashme. Në sistemin e prokurimit elektronik, nga ana e shoqërisë sonë është ngarkuar punë e ngjashme me objekt: “Asfaltimi i rrugës Dol – Kusar Godën, Gjakovë, faza e II-të”. Referuar kriterit 2.3.1 të

kërkesave të DST-së, thuhet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më e vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
ose
- b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anetari i cili ka përqindjen me të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anetaret e tjera të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anetar të një bashkimi, kanë të njëjten përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marreveshje në kontratën e bashkëpunimi se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anetaret e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. 2.3.2 për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: për plotësimin e këtyre kriterëve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, Operatori/et Ekonomikë duhet të paraqes/in si dëshmi, vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohet vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, dokumentacionin e mëposhtëm:

- I. Kontratën e sipërmarrjes,
- II. Situacionin përfundimtar të objektit
- III. Aktin e Kolaudit të objektit
- IV. Certifikatë e marrjes në dorëzim të objektit
- V. Formular vlerësimi nga Investitori

Së pari, për sa më sipër, punë të ngjashme të plotëson 50% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, pasi vlera e realizuar e kontratës është 799,650.04 euro dhe sipas kursit të këmbimit 1 euro = 97 lekë, që do të thotë vlera totale e kontratës së paraqitur nga ana jonë është 65,733,950 lekë pa TVSH.

Së dyti, referuar procesverbalit të aktit të kolaudit, rezulton që data e mbajtjes së tij është 12.10.2020, që do të thotë se puna e ngjashme e paraqitur nga ana jonë është brenda afatit 5 vjeçar, të kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Së treti, dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti kontraktor për vërtetimin e realizimit të punës së ngjashme është paraqitur nga shoqëria jonë, madje, duke qenë se është një kontratë e

realizuar në Republikën e Kosovës dhe dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti kontraktor mund të ketë emërtime të ndryshme, kemi paraqitur një deklaratë ku i shpjegojmë këto terma, për shembull, raporti përfundimtar është i barabartë me aktin e kolaudimit.

Shoqëria jonë ka paraqitur dokumentacion të plotë dhe të mbështetur në përvojën konkrete të kryer, e cila është ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik dhe përmbush qartë objektin, dokumentacionin dhe vlerën e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Gjithashtu, në aktin e kolaudimit është specifikuar qartë që kontrata është realizuar me sukses dhe sipas kushteve të kontratës. Për të vendosur ne dukje edhe njëherë rolin e kolaudatorit, vlen të theksohet se në pikën 3 të kreut II të udhëzimit nr.3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe aktin e kolaudimit të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, parashikohen detyrat kryesore të kolaudatorit, sic janë: “kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:

- a) Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.
- b) Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.
- c) përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.
- d) përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes”.

Prandaj, arsyeja e skualifikimit të dhënë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është e paqartë për shoqërinë tonë dhe për më tepër, e konsiderojmë atë diskriminuese. Komisioni i vlerësimit të ofertave nuk ka sqaruar në mënyrë të qartë dhe të argumentuar se cilat janë konkretisht elementet që, sipas tij, nuk përmbushen nga shoqëria jonë në kriterin e punës së ngjashme. Kjo bie në kundërshtim me parimin e transparencës të parashikuar në pikën 1 të nenit 3 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale”, dhe detyrimin për arsyetim të akteve administrative sic parashikohe edhe në nenin 100 të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, thuhet se: Akti administrativ i shkruar në letër ose elektronik, si dhe akti administrativ i konfirmuar, sipas nenit 98, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, duhet të jetë i arsyetuar. Arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban:

- a. Shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë akti;
- b. Shpjegimin e përmbledhur të rezultatit të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të provave;
- c. Bazën ligjore të aktit dhe një shpjegim pse kushtet ligjore për zbatimin e tij plotësohen në këtë rast;
- d. Në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar”.

Që do të thotë se cdo akt administrativ duhet të jetë i arsyetuar qartë, në mënyrë që palët të kuptojnë bazën ligjore dhe faktike mbi të cilën është marrë vendimi. Mungesa e qartësisë dhe sqarimeve nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave pengon të drejtën tonë për të ushtruar mbrojtje, c’ka përbën një cenim të parimit të mosdiskriminimit dhe të drejtës për pjesëmarrje të barabartë. Përsa argumentuam më sipër, kërkojmë rivlerësim dhe një argumentim në lidhje

me vendimin e Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e shoqërisë sonë, që ne si operatorë ekonomik të kemi mundësi mbrojtje.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 2480/1 prot., datë 16.09.2025 janë publikuar arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h kundërshton me anë të ankesës me nr. 2480/2025 prot, datë 15.09.2025.

II.8. Me shkresën nr. 4101 prot, datë 18.09.2025 me objekt “Dërgim Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave”, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 2480/2 prot datë 22.09.2025 autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik, aktin e trajtimit të ankesës nr. 1, datë 18.09.2025 të operatorit ekonomik ankimes, nga verifikimi i të cilit rezulton se ka vendosur mospranimin e ankesës me argumentat si më poshtë vijon:

Mbi shqyrtimin e ankesës të operatorit “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h, me nr Nipt L04803001U në lidhje me objektin e procedurës së prokurimit me numer REF-53029-07-01-2025 perkatesisht procedurës së prokurimit me objekt “Sistemim asfaltim i rruges lidhese te fshatit Dragu dhe fshati Koçaj, NjA Fushe-Bulqize”.

Mbeshtetur në ligjin 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe të VKM nr 285 datë 19/05/2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, urdherin nr 2768/8 prot, datë 16/09/2025 “Për Krijimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave” u mbledh Komisioni shqyrtimit të ankesave për shqyrtimin e ankesës së bërë nga “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h, me nr Nipt L04803001U.

Në procedurën e prokurimit me objekt: “Sistemim asfaltim i rruges lidhese te fshatit Dragu dhe fshati Koçaj, NjA Fushe Bulqize” me nr REF-53029-07-01-2025 me fond limit: 20.500.000 (nëzet milion e pesëqind mijë) leke pa TVSH, operatori ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h, ka paraqitur ankesën e tij brenda afatit ligjor, dhe në formularin e ankesës pretendon që arsyeja e skualifikimit është e paqarte, në lidhje me atë çfarë konkretisht nuk plotëson në lidhje me punën e ngjashme.

Nga shqyrtimi i dokumentave të ngarkuar në sistem nga ana e operatorit ekonomik rezulton që janë paraqitur si punë të ngjashme kontrata me objekt: “Asfaltimi i Rruges Dol-Kusar-Godën, Gjakovë, faza e II-te”. Në proces-verbalin e pranimin teknik dhe të llogarisë përfundimtare për projektin “Asfaltimi i Rruges Dol-Kusar-Godën, Gjakovë, faza e II-te” citohet ndër të tjera se “Data e fillimit të punimeve është data 02.11.2016 kurse data e mbarimit të punimeve është data 03.06.2020”.

Njoftimi i kontratës për procedurën: “Sistemim asfaltim i rruges lidhese te fshatit Dragu dhe fshati Koçaj, NjA Fushe Bulqize” është bërë me dt 02.07.2025.

*Në DST ne pikën 2.3.1 thuhet se për te provuar pervojen e mëparshme AK kerkon:
2.3.1 Për te provuar pervojën e meparshme, autoriteti kontraktor kerkon:*

a) Pune e ngjashme per nje objekt te vetem ne nje vlere jo me e vogel se 50% e vleres se perllogaritur të kontrates qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjatë pese viteve te fundit, nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates;

Nga llogaritja e atyre qe percaktuam me siper, mbarimi i punimeve eshte ne nje afat me te gjate se 5 vjecar, afati i numerimit 5 vjecar fillon nga dt 03.06.2020 dhe perfundon me dt. 03.06.2025. Nderkohë qe duket qartas se nuk eshte brenda afatit 5 vjecar sepse njoftimi i kontrates per proceduren tonë është berë më dt.02.07.2025.

Nga sa u konstatua rezulton se kontrata e paraqitur nga Operatori Ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h, eshte realizuar ne nje periudhe me shume se 5 vite nga data e shpalljes se njoftimit të kontrates. Njoftimi i kontrates eshte me date 02.07.2025 dhe punët e ngjashme te kryera jane para dates 02.07.2020 qe eshte afati 5 vjeçar.

Sa me siper ankeses se paraqitur, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave

Vendos:

1. Mos pranimin e ankeses se operatorit ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h ne lidhje me punën e meparshme te ngjashme te kryera gjate pese viteve te fundit.

II.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 Për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij, në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyen se: “Nuk ploteson kriterin 2.3.1 ne lidhje me punen e ngjashme” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.1 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më e vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Ose

- b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anetari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anetaret e tjera të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anetar të një bashkimi, kanë të njëjten përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anetaret e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

III.1.2. Në përmbushje të kriterit më sipër operatori ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE dokumentacionin si më poshtë:

- Deklaratë e RSM Company në të cilën deklarohet se:
 - “1. Në Republikën e Kosovës, Autoriteti Kontraktor nuk lëshon formularë Vlerësimi, por në përfundim të Kontratës Autoriteti Kontraktor lëshon një referencë e cila është analoge me formularin e Vlerësimit*
 - 2. Në Republikën e Kosovës Autoriteti Kontraktor nuk lëshon akt kollauidimi për objektin dhe as certifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve por për aktin e kollauidimit dhe certifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve autoritetet kontraktore në Republikën e Kosovës lëshojnë dokumentin: Raport Përfundimtar*
 - 3. Situacioni përfundimtar sipas legjislacionit të Kosovës përfshin Faturë+Certifikatën e Zhvillimit Financiar të Kontratës+Paramasa dhe Parallogaria. Në çdo vit punë lëshohet një situacion përfundimtar që përfshin dokumentat e mësipërme.*
 - 4. Në Republikën e Kosovës, në fazën e tenderimit nuk kërkohet prokurë e posaçme por vetëm akt-marrëveshja e bashkëpunimit të operatorëve.”*
- Kontratë Publike me numër identifikues: MI-16-073-5.1.1 dhe numër të kontratës 48/2016 e nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës së Kosovës dhe shoqërisë “RSM Company” me objekt “Asfalti i rrugës Dol-Kusar-goden, Gjakovë, faza II-të”, me vlerë 799,650.04 euro me TVSh.
- Vërtetim Kopje me Originalin me LRP.nr. 15274/2021 lëshuar nga noteri Z. Aliu, Lipjan me datë 17.12.2021
- Apostilë lëshuar në Prishtinë me datë 10.01.2022 me nr: DCK/22-001077.
- Faturë nr. 105/16 datë 06.12.2016
- Certifikatë e zhvillimit financiar me referencë nr. 1748 datë 07.12.2016 bashkëlidhur së cilës Paramasa Rrugës (Shkolla e vjetër e Dolit-Kusar-Goden-Qafë Dobrunë)

- Faturë nr. 29/2017 datë 25.05.2017
- Certifikatë e zhvillimit financiar me referencë nr. 968 datë 02.06.2017 bashkëlidhur së cilës Paramasa Rruga-(Shkolla e vjetër e Dolit-Kusar-goden-Qafë Dobrunë)
- Faturë 42/17 datë 04.08.2017
- Certifikatë e zhvillimit financiar me referencë nr. 1454 datë 09.08.2017 bashkëlidhur së cilës Paramasa Rruga-(Shkolla e vjetër e Dolit-Kusar-Goden-Qafë Dobrunë)
- Faturë nr. 50/2017 datë 21.09.2017
- Certifikatë e zhvillimit financiar me referencë nr: 1820, datë 02.10.2017 bashkëlidhur së cilës situacioni IV Rruga-(Shkolla e vjetër e Dolit-Kusar-Goden-Qafë Dobrunë)
- Faturë nr. 30/18 datë 01.08.2018
- Paramasa Rruga-(Shkolla e vjetër e Dolit-Kusar-Goden-Qafë Dobrunë)
- Faturë nr. 34/18 datë 24.08.2018
- Certifikatë e zhvillimit financiar me referencë nr. 1821 datë 24.08.2018 bashkëlidhur së cilës Paramasa Rruga-(Shkolla e vjetër e Dolit-Kusar-Goden-Qafë Dobrunë)
- Faturë nr. 39/218 datë 25.09.2018
- Certifikatë e zhvillimit financiar me referencë nr: 2136 dhe datë 26.09.2018 bashkëlidhur së cilës Paramasa Rruga-(Shkolla e vjetër e Dolit-Kusar-Goden-Qafë Dobrunë)
- Faturë 47/18 datë 10.10.2018
- Cerifikatë e zhvillimit fiannciar me referencë nr. 2315 dhe datë 11.10.2018 bashkëlidhur së cilës Paramasa Rruga-(Shkolla e vjetër e Dolit-Kusar-Goden-Qafë Dobrunë)
- Faturë nr. 66/18 datë 23.11.2018
- Certifikatë e zhvillimit financiar me referencë nr. 2807, datë 27.11.2018 bashkëlidhur së cilës Paramasa Rruga-(Shkolla e vjetër e Dolit-Kusar-Goden-Qafë Dobrunë)
- Faturë 25/19 datë 06.06.2019
- Certifikatë e zhvillimit financiar me referencë nr:1192 datë 10.06.2019 bashkëlidhur së cilës Paramasa me parallogari e riformatuar për ndërtimin e Segmentit III të Kontratës Asfaltim i rrugës Dol-Kusar-Goden (Gjakovë) faza e II” me nr. Prok.MI -16-073-511/16, sipas projektit të Komunës së Gjakovës (Punime të mbetura)
- Faturë nr. 66/19 datë 01.11.2019
- Certifikatë e zhvillimit financiar me referenca nr. 2948 datë 06.11.2019 bashkëlidhur së cilës Paramasa Rruga-(Shkolla e vjetër e Dolit-Kusar-Goden-Qafë Dobrunë) dhe Paramasa me parallogari e riformatuar për ndërtimin e Segmentit III të Kontratës Asfaltim i rrugës Dol-Kusar-Goden (Gjakovë) faza e II” me nr. Prok.MI -16-073-511/16, sipas projektit të Komunës së Gjakovës (Punime të mbetura)
- Faturë 44/20 datë 28.10.2020
- Certifikatë e zhvillimit financiar me referencë nr. 1458, datë 02.11.2020 bashkëlidhur së cilës Paramasa Rruga - (Shkolla e vjetër e Dolit-Kusar-Goden-Qafë Dobrunë) dhe Paramasa me parallogari e riformatuar për ndërtimin e Segmentit III të Kontratës Asfaltim i rrugës Dol-Kusar-Goden (Gjakovë) faza e II” me nr. Prok.MI -16-073-511/16, sipas projektit të Komunës së Gjakovës (Punime të mbetura)
- Paramasa me parallogari e riformatuar për ndërtimin e Segmentit III të Kontratës Asfaltim i rrugës Dol-Kusar-Goden (Gjakovë) faza e II” me nr. Prok.MI -16-073-511/16, sipas projektit të Komunës së Gjakovës (Punime të mbetura)
- Faturë 46/20 datë 02.11.2020

- Certifikatë e zhvillimit financiar me referencë nr. 1487 datë 03.11.2020 bashkëlidhur së cilës Paramasa Rruga - (Shkolla e vjetër e Dolit-Kusar-Goden-Qafë Dobrunë) dhe Paramasa me parallogari e riformatuar për ndërtimin e Segmentit III të Kontratës “Asfaltim i rrugës Dol-Kusar-Goden (Gjakovë) faza e II” me nr. Prok.MI -16-073-511/16, sipas projektit të Komunës së Gjakovës (Punime të mbetura)
- Vërtetim kopje me origjinalin LRP.nr. 254/2022 lëshuar nga noteri Z.Aliu në Lipjan me datë 12.01.2022.
- Apostile lëshuar në Prishtinë me datë 13.01.2022 me nr. DCK/22-002369
- Referencë nr. 8634 prot datë 30.10.20 lëshuar nga Ministri e Infrastrukturës e Kosovës, Departamenti i Menaxhimit të Rrugëve me temë” “Dorëzim i procesverbalit të pranimit teknik dhe llogarisë përfundimtare për kontratën “Asfaltim i Rrugës-Dol-Kusar-Goden, Gjakovë, faza II-të”.
- Procesverbal i Pranimit Teknik dhe Llogarisë përfundimtare për projektin i Komisionit për Pranim Teknik dhe Llogari Përfundimtare për projektin: “Asfaltim i Rrugës Dol-Kusar-Goden, Gjakovë, faza II-të” (me nr. Id: MI-16-073-5.1.1 dhe nr.kontratës: 48/2016, datë 28.09.2016 i cili ka propozuar: *“Të pranohen punimet e kryera , leja e përdorimit mund të jepet nga organi kompetent meqë janë plotësuar kushtet e stabilitetit dhe sigurisë në komunikacion të fillohet me llogarinë përfundimtare të punëve të kryera”*.
- Vërtetim kopje me origjinalin LRP.nr. 15275/2021 lëshuar nga noteri Z.Aliu në Lipjan me datë 17.12.2021.
- Apostile lëshuar në Prishtinë me datë 10.01.2022 me nr. DCK/22-001074.

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.5. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së, i ndryshuar, përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.*

III.1.6. Në nenin 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet se:

“5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera,

afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”

III.1.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai i barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.8. Referuar legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të kualifikimit dhe të specifikimeve teknike, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor, për sigurimin e produktit/mallit sa më cilësor, me qëllim realizimin me sukses të kontratës dhe përmbushjen e nevojave. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kriteret për kualifikim dhe specifikime teknike, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë se, autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit, ka kërkuar që për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon a) *Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më e vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit*

të kontratës; ose b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Pika 2.3.1/a plotësohet nga anetari i cili ka përqindjen me të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anetarët e tjere të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anetar të një bashkimi, kanë të njëjten përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anetarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.1, dhe i cili do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar në datën e dorëzimit të ofertave. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik ankimes "R|S|M CONSTRUCTION" d.sh.h, për përmbushjen e kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur në SPE dokumentacionin e përmendur në pikën III.1.2. të këtij vendimi. Referuar raportit të auditit në SPE, Komisioni konstaton, se nga ana e KVO nuk janë dhënë shpjegime në mënyrë shteruese, lidhur me mospërmbushjen e këtij kriteri të sipërpërmendur nga ana e operatorit ekonomik ankimes. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimes, arsyenë së skualifikimit të dhënë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, referuar raportit të auditit në SPE, si dhe dokumentacionit të operatorit ekonomik "R|S|M CONSTRUCTION" d.sh.h, të dorëzuar në SPE, në përmbushje të kriterit për kualifikim të mësipërme, Komisioni gjykon se, është në kushte të paqarta dhe në pamundësi për të vlerësuar mbi arsyen e skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, konkretisht në vlerësimin e dhënë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, sepse ky i fundit nuk ka dhënë apo evidentuar qartë se çfarë ky operator ekonomik nuk plotëson për këtë kriter, pasi një punë e ngjashme që të konsiderohet si tillë duhet të përmbushë 3 komponentë njëkohësisht si **komponentin kohë** (ku për këtë komponentë duhen marrë në konsideratë ato kontrata të cilat janë brenda afatit kohorë 5 vjeçar nga data e njoftimit të kontratës), **komponenti vlerë** (lidhet me madhësinë e kontratës ose kontratave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në kriterin 2.3.1 pra për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se xxxxxx lekë apo vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se xxxxxx lekë) si dhe **komponentit natyrë e ngjashme** (i cili lidhet me natyrën e ngjashme të kontratave të dorëzuara nga operatori ekonomik me objektin e prokurimit nisur jo vetëm nga emërtesa e kontratës por edhe nga zërat e preventivave të tyre), duke mos marrë në analizë komponentët e sipërcituar në lidhje me përmbushjen e kriterit të punëve të ngjashme, autoriteti kontraktor e ka vendosur operatorin ekonomik në një pozitë jo të qartë, konfuze dhe jo të argumentuar. Në këto kushte, autoriteti kontraktor ka vënë në pozita të paqarta dhe konfuze operatorin ekonomik ankimes për të argumentuar apo kundërshtuar vlerësimin e dhënë për këtë të fundit për arsyen e skualifikimit, në lidhje me kriterin e punëve të ngjashme. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të rikthejë procedurën e prokurimit objekt ankimi, nga statusi aktual në statusin e fazës së vlerësimit, sepse secili anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave duhet të evidentojë qartë dhe saktë, se cili komponentë të punës së ngjashme nuk përmbush ky operator ekonomik ankimes referuar dokumentacionit të dorëzuar në përmbushje të kriterit 2.3.1 të përcaktuar nga vetë autoriteti kontraktor.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatorit ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-53029-07-01-2025, me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës lidhëse të fshatit Dragu dhe fshati Koçaj, NjA Fushë Bulqizë” me fond limit: 20.500.000 (njëzet milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 17.07.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Bulqizë.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h në baze të konstatimeve të shprehur në këtë vendim.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorit ekonomik “R|S|M CONSTRUCTION” d.sh.h.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Florent Zguro

